



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË



M. 43p10t

22/12/2025

VENDIM

Nr. 32, datë 17.12.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT
“ALBA-BETON 07” SH.P.K., ME VENDNDODHJE: SUPERSTRADA
SHKODËR-LEZHË KM14, BUSHAT, SHKODËR.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “Alba-Beton 07” sh.p.k., me vendndodhje: Superstrada Shkodër-Lezhë km14, Bushat, Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor:

- X = 463152
- Y = 4645766
- Z = 10.4 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 2.6$ l/sek

- Qëllimi i përdorimit: Larjen e inerteve të siguruar nga leja minerare Nr.1800, datë 10.05.2016 me afat 25 vjet, si dhe për prodhim betoni.

- Thellësia e pus-shpimit: 8 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : Në sipërfaqe
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)


X= 463218; Y= 4645863; Z= 11.6 m

- Prurja që shkarkohet: Q= 0.52 l/sek
- Trupi ujqor pritës: KK-85 (Shkjezë)

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË

 **HOLTA DUDA**